

DITARI MUJOR

MARS 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

STAFET E KABINETEVE TRAJNIM PËR INTEGRITETIN

U prezantua moduli online i trajnimit "Hyrje në parandalimin e korrupsionit" për stafet e kabineteve në ministri, i realizuar falë një bashkëpunimi të Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin me zyrën e Këshillit të Europës në Tiranë. Moduli është i përshtatur me legjislacionin shqiptar dhe praktikën e insitucioneve përgjegjëse për forcimin e integritetit, dhe është një ndër kurset më bashkëkohore për edukimin online mbi integritetin. Ky modul i shtohet Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).



KONFERENCA "FORCIMI I LLOGARIDHËNIES", BALLKANI PERËNDIMOR BASHKË KUNDËR KORRUPSIONIT



Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, së bashku me Ministrinë e Drejtësisë dhe Iniciativën Globale Kundër Krimin të Organizuar, organizuan konferencën ndërkombëtare "Forcimi i Llogaridhënies". Përfaqësues të qeverive nga vendet e Ballkanit Perëndimor, institucioneve të specializuara të luftës antikorrupsion, shoqërisë civile dhe akademike diskutuan për dy ditë me radhë mbi instrumentat më efektive për forcimin e llogaridhënies dhe integritetit në administratën publike. Mbi 8 panele të dedikuara bënë bashkë 22 zyrtarë të lartë dhe përfaqësues të autoriteteve ligjzbatuese antikorrupsion nga 6 vende të BP. Mbi 50 panelistë, si dhe mbi 20 organizata ishin gjithashtu pjesë e eventit.

MINISTRJA PIRDENI TAKON CEO-N E TRANSPARENCY INTERNATIONAL

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, realizoi një takim konstruktiv me CEO e Transparency International, Z. Daniel Eriksson, për qasjen e Qeverisë shqiptare për të forcuar muret mbrojtëse ndaj korrupsionit përmes instrumenteve të forcimit të integritetit dhe përqafimit të digjitalizimit.



TAKIM ME NDIHMËS SEKRETARIN AMERIKAN TE SHTETIT Z. TODD ROBINSON: FOKUSI TEK AGJENDA ANTIKORRUPSION!



Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, u takua me Ndihmës Sekretarin e Shtetit për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit, Todd Robinson. Gjatë takimit theksi u vu te intensifikimi i agjendës antikorrupsion të Qeverisë Shqiptare. Z. Robinson theksoi mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, partner strategjik në fuqizimin e llogaridhënies dhe konsolidimin e institucioneve demokratike të vendit.

DITARI MUJOR

MARS 2024

MINISTRJA PIRDENI NË KOMISIONIN EVROPIAN PËR PROGRESIN E SHQIPËRISË NË FUSHAT PRIORITARE TË NEGOCIATAVE

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, paraqiti me sukses përpara Komisionit Evropian progresin më të fundit të Shqipërisë mbi ecurinë e reformave në fusha jetike për konsolidimin e shtetit të së drejtës. Gjatë ditës së parë të Takimit të Nënkomitetit të 15-të të Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë, u prezantua ecuria e reformës në sistemin e drejtësisë, lufta kundër korrupsionit, përmirësimi i kuadrit legjislativ dhe strategjik për të përmbushur kërkesat e BE-së dhe GRECO-s, si dhe masat e marra për të parandaluar korrupsionin në sektorë me risk të lartë.



VAJZAT E EKSELENCËS NË ADMINISTRATË, PIRDENI: BASHKË FORMËSOJMË ADMINISTRATËN E GJENERATËS SË RE

Në kuadër të muajit dedikuar vajzave dhe grave, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni bashkëbisedoi me një grup vajzash, të punësuar përgjatë viteve në institucionet shtetërore falë Programit të Ekselencës. Në shërbimin civil punojnë 387 vajza, falë këtij programi. Gjatë bashkëbisedimit ministria Pirdeni vuri në dukje se ato janë burim frymëzimi për të gjithë administratën, e cila është në proces transformimi për t'u afruar të gjitha kushtet që ato të vazhdojnë të jenë një aset i çmuar i institucioneve shtetërore dhe të zhvillohen në karrierë.

PASDITE ME AADF ALUMNI, PIRDENI: VIZIONI YNË PËR ADMINISTRATËN 2030!

Ministria Pirdeni zhvilloi një dialog shumë interesant e angazhues me alumni të AADF për vizionin e "Administrata 2030". Pasi bëri një paraqitje të hapave që do të ndërmerren për të transformuar më tej administratën, dhe thelluar luftën antikorrupsion, Ministria Pirdeni iu përgjigj dhe pyetjeve të shumta të alumnit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN



Ministër i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin
Adea Pirdeni



mapa.gov.al
adeapirdeni



APirdeni